

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

**08.06.2023
Ora 13:20**

RENDI I DITËS

Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.85, me subjekt ankues: “Koalicioni Bashkë Fitojmë. Rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në QV2373/01 dhe nr.2481/01 dhe nr.2483/00” (Elbasan).

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin Lako, Z.Elvis Çefa, Z.Ilirjan Rusmali,
Z.Koli Bele, Z.Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** BF (Z. F. Nuri, Z. B. Himçi)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. L. Braho: Mirëdioda çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 85 datë 24.05.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Seanca e kaluar u ndërpre me qëllim që KAS të merrte kohë për shpalljen e vendimit. Kështu që mbështetur në nenet 21 pika 1 shkronja b dhe 143 pika 1 shkronja d të Kodit Zgjedhor. KAS me shumicë votash vendosi:

- Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.85 datë 24.05.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë.
- Lënien në fuqi të vendimit nr.539 datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Elbasan, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 14 Maj 2023.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

U shpall sot me datë 8.06.2023. Seancën e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr. 177

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

08.06.2023
Ora 13:36


"Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.67 dhe nr. 74. Subjekti ankues:Koalicioni "Bashkë Fitojmë", z.Lefter Maliqi. 1.Ndryshimin e vendimit nr.101, datë 16.06.2023 të KZAZ-së nr.64 Bashkia Kuçovë, Qarku Berat " Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kuçovë. 2.Rinumërim dhe rivlerësim i votave për KZAZ nr.64 për të gjitha QV.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** BF (z.A. Kaziaj)
- **Të tjerë:** Kandidati për kryetar z.Lefter Maliqi, Avokatët Arben Llangozi dhe Orgesa Serani.

Z. K. Bele: Çelim seancën e shqyrtimit në themel të kërkesës ankimore nr.67 bashkuar me kërkesën nr.74. Reletaojmë se seanca është ndërprerë me kërkesë të palëve pasi kishte një ankim lidhur me një çështje, me një vendim që lidhej me një ankim të bërë nga palët në Kolegjin Zgjedhor, lidhur me objektin e njërëz nga kërkesat dher konkretisht me një vendim të mëparshëm të KAS atë me numër 136. Relatojmë se lidhur me këtë ankim ka pasur një vendimmarrje të kolegjit dhe konkretisht në datë 7.06. Kolegji Zgjedhor ka vendosur sipas shkurtimit të vendimit pranimin e pjesshëm të padisë, shfuqëzimin e pikës 2 të vendimit nr. 136 datë 24.05. të KAS. Detyrimin e KAS të bëj pjesë të

*Zbardhi materialin audio
Ardita CAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

shqyrtimit kërkimet e rrëzuara për shkak kompetence të kërkesës ankimore nr. 74 datë 22.05.2023 të ankuesit Lefter Maliqi, në kuadër të shkaqeve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Pushimin për pjesën tjetër të padisë. Megjithatë në këtë fazë verifikojmë prezencën për procedurë të palëve, KAS i mbledhur nga 5 anëtarët e mbledhur prezent. Verifikohet prezenca gjithashtu e administratës me Sekretarin e Përgjithshëm dhe ekipin e tij. Si dhe kemi prezent për rekord për palën ankuese janë.

Av. Orgesa Serani: Përfaqësuese ligjore

Av. Arben Llangozi.

Z. K. Bele: Si dhe për koalicionin

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i BF-së: I pranishëm.

Z. Lefter Maliqi: Kandidat i propozuar nga BF.

Z. K. Bele: Për person të interesuar kemi ndonjë informacion?

Z. Y. Merkaj: Po kemi komunikuar me ne në telefon përfaqësuesit e PS-së. Kërkojnë shtyrjen e seancës pasi ka pasur një angazhim tjetër në një proces gjyqësor tjetër.

Z. K. Bele: Në rregull. Duke qenë se subjekti politik ka më shumë se një përfaqësues edhe duke qenës se është palë e interesuar. Duke pasur parasysh edhe

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*


afatet proceduriale mbi të cilat ne duhet të shprehemi. KAS i konsultuar në vend çmon se duhet të vazhdojë në mungesë të tyre. Gjithësesi nëse ata arrijnë gjatë procesit mundet të futen në proces nëse do të dëshirojnë, ta bëjnë një gjë të tillë. Paraprakisht relatova vendimin e Kolegjit i cili na kthen në situatën që dy vendime të bashkuara në themel do të shqyrtohen sipas objektit të plotë të këtyre vendimeve. Duke e rikthyer procesin në fazën e parë tek kërkimet e palëve. Në këto kushte i japim fjalën përfaqësuesit të palës kërkuese të fillojnë me parashtrimet apo kërkesat , të marri fjalën edhe të vazhdojë procedurë.

Av. A. Llangozi: Në dijeninë time pavarësisht se ndoshta ju, u është komunikuar vetëm shkurtimi i vendimit por shkurtimisht gjykata e ka lënë detyrë që çështja të gjykohet në këtë fazë që është dhe jo të kalojë në seancë paraprake. Pra, që do të thotë që Kolegji Zgjedhor ka vlerësuar që kompetente për gjykimin e asaj çështje jeni ju si trup gjykues. Kjo është thelbi i gjykimit në kolegji por jo të fillojmë në seancë paraprake sipas nenit 130.

Z. K. Bele: Ndoshta nuk u kuptuam. Pra ne kthehemi në seancën e shqyrtimit në themel ku u ndërpre por objekti tashmë i kësaj seance do jenë objektet e bashkuara të kërkesës 67 dhe 74. Kufizimi që ishte bërë me vendimmarrjen e mëparshme të KAS me vendimin nr.136, objektit të kërkesës tuaj 74 është rrëzuar nga kolegji me këtë shqyrtim dhe ne jemi përcaktuar si organi kompetent që do të çmojmë për çfarë ngrihet në atë kërkim, në atë kërkesë ankimore.

Av. A. Llangozi: Unë kam një kërkesë tjetër që do ta paraqes para kolegjit në rastin aktual përpara KAS. Kërkoj përpara jush marrjen e masave të përkohshme, me vendim të ndërmjetëm të arsyetuar sepse vendimet e ndërmjetme ndahen në dy


*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

kategori, vendimet të ndërmjetme të arsyetuara dhe jot ë arsyetuara. Të cilat kanë të bëjnë me mbarëvatjen e procesit aktualisht. Në mënyrë skandaloze KQZ na ka priivuar të drejtën tonë për të marrë prova. I kemi kërkuar KQZ-së marrjen e disa pamjeve filmike të QV të cilat i kemi kërkuar të gjitha, është e drejta jonë që ne ti marrim këto pamje filmike dhe deri ditën e sotme organi që ka për detyrë ti japi këto prova të cilat ne i kemi kërkuar nuk na janë vënë në dispozicion. Provat janë përveç pamjeve filmike ne kemi kërkuar edhe disa akte që është vendimi me numër 3886 datë 23.6.1996 objekt gjykimi aktualisht dhe në mënyrën më të paturpshme ku sekretari i këtij institucioni na ka kthyer email ku pretendon se nuk ka dëshirë edhe vullnet të na i vëjë në dispozicion këtë akt. Duke qenë se në Kodin Zgjedhor ashtu edhe në Kodin e Procedurave Administrative është një e drejt e jona ashtu edhe në ligjin për Avokatinë është një e drejtë e jona që ne të marrim akte me qëllim realizimin e një mbrotje dhe nuk është në vullnetin e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së që ne të na privojë akte të cilat ne i kemi kërkuar. Ne i kemi kërkuar këto akte në cilësinë e kandidatit të Bashkë Fitojmë dhe nga Sekretari i Përgjithshëm nëpërmjet një emaili, email dhe shkresat kanë qenë të shumta pothuajse çdo ditë ne kemi kërkuar të marrim nga ky institucion, të na vihen në dispozicion pamjet filmike, të na vihen në dispozicion edhe këto akte të cilat i kemi kërkuar. Një ndër aktet ka qenë edhe deklarimi i shtetasit Kreshnik Hajdari që sërish është objekt gjykimi në këtë proces, që sipas nesh është i flasifikuar dhe i pa vlefshëm. Sepse pa vlefshmëria e veprimit juridik tashmë me vendimin e Kolegjit Zgjedhor është detyrë e juaja ta gjykoni sepse shumë rëndom unë edhe në kolegji këtë pretendim që akti i përfaqësimit tim është një shprehje vullneti ose është një veprim juridik i një anshëm dhe është një akt që ju me të drejtë e keni verifikuar dhe më keni legjitimuar mua. E njëjta gjë është edhe vet deklarimi që shtetasi Kreshnik Hajdari i është drejtuar KQZ-së është një akt, veprim juridik ku ka

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

shfaqur vullnetin për të kandiduar. Është një provë e cila ne na është dhënë vetëm ditën e sotme. Ndërkohë vendimi dhe pamjet filmike deri në ditën e sotme me 10-tra kërkesa të përditshme nuk na janë dhënë në dispozicion. E keni kërkesën me shkrim do ti paraqësim edhe aktet e shkruara edhe ne kërkojmë si përfundim me vendim të ndërmjetëm marrjen e masave provizore në bazë të nenit 67 Kodit të Procedurave Administrative. Sekuestrimin e materialeve zgjedhore si, pamje filmike, procesverbale të mbylljes së kutive, kutitë me fletët përkatëse të votimit, paisjet PEI, materialet filmike të Qëndrave të Votimit dhe çdo material tjetër zgjedhor. Pasi këto material rrezikohet që të jenë në dorën e një Sekretari të Përgjithshëm, i cili nuk ka vullnet që të na japin akte. Kjo është e shprehur nëpërmjet email të fundit. Njëkohësisht kërkojmë sekuestrimin e dokumentave të paraqitura nga palët si, formularin e vetdeklarimit, këtë e morëm dhe heqim dorë. Ne kërkojmë sekuestrimin e vendimit të dënimit me nr 3886 datë 23.06.1999, të kandidatit Kreshnik Hajdarit dorëzuar pranë KQZ nga koalicioni “Bashkë Fitojmë, nëpërmjet shkresës 220, datë 04.04.2023. Ky vendim dënimi është fshehur në mënyrën më të tmerrshme sërish nga personi që unë e akuzoj në mënyrë të drejtëpërdrejtë se na ka sjellë email që është fshehur edhe Prokurorit të Përgjithshëm me arsyetimin se ne kemi një praktikë që nuk i vëmë në dispozicion aktet organit procedues që në rastin aktual është prokuroria. Por referuar Kodit Penal cili do ka dijëni për një vepër penale apo një fakt që përbën vepër penale ka detyrimin përveç kallzimit të depozitujë edhe provën. Mos depozitimi i provës përpara këtij organi procedues është vepër penale. Ne mendojmë dhe na krijohet bindja me aktet e mësipërme që këto materiale zgjedhore do të rrezikohet zhdukja e tyre. Një provë tjetër thelbësore është edhe një denoncim që është bërë për televizionin ORA News të cilin e kemi paraqitur edhe si provë. Ku pretendohet se një anëtar i GNV në KZAZ Kuçovë është urdhëruar nga eprorët e tij që të

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

zhdukin procesverbalët original dhe në këtë video në fundin e saj, duken që janë një sërë procesverbalesh original, të cilat mungojnë në dosje dhe ne e kemi ngritur pretendim përpara jush. Për këto rrethana ne kërkojmë që më të sigurta do të jenë tek ju sepse pavarësisht se u prish një vendim i ndërmjetëm, ky ishte një mendim i juaj dhe ne nuk mundet është çështje interpretimi, çështje mendimi dhe ne nuk mundet të paragjykojmë. Jemi jurist dhe ne mendojmë që më të sigurta këto dhe këto prova të cilat ne i kërkojmë të jenë pranë jush. Për këto arsye ne kërkojmë pranimin e kësaj kërkesë, kërkesa është me shkrim dhe kemi edhe provat bashkëlidhur. Mund ti lexojmë provat, kërkesën e kemi. Shkurtimisht pavarësisht se janë 24 orë detyrimi për të na vënë në dispozicion aktet, kanë kaluar 14 ditë sot që nuk na janë vënë në dispozicion.

Av. O. Serani: Është një email i dërguar ditën e sotme në orën 09:30 nëpërmjet të cilit ne kemi kërkuar në mënyrë të ripërsëritur vendimin e dënimit të zotit Kreshnik Hajdari, pamjet filmike të QV dhe formularin e dekriminalizimit të depozituar nga zoti Kreshnik Hajdari. Po ashtu edhe në orën 09:10 ditën e sotme kemi kërkuar të na vihet në dispozicion një kopje e njësuar me origjinalin e vendimit të KZAZ-së me nr.64 Kuçovë, për shtyrjen e numërimit të votës nga ora 11 deri në orën 12 e 30. Një email i cili na është dërguar zoti Ylli Merkaj, i cili thotë se në përgjigje të kërkesave tuaja sqarojmë sa më poshtë: në lidhje me pamjet filmike për të gjitha QV ju sjellim në vëmendje se jemi në proces të ekstratimit të të gjitha pamjeve filmike në përmbushje të kërkesave tuaja. Nisur nga numri i madh i QV dhe sasia e madhe e informacionit për çdo qëndër kërkohet kohë për procesimin e tyre. Pamjet filmike

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

Av. A. Llangozi: Më fal, në këtë pikë ne atë ditë sa po kishim marrë nga KQZ diviarin që ne kishim sjellë për të marrë komplet materialin zgjedhor dhe ne nuk na ishte vënë në dispozicion. Më vonë na kanë nisur atë email që pajisja jonë nuk ishte fare në KQZ dhe ky email është fiktiv në këtë pjesë nuk është i vërtet sepse pajisjen ne këto momente e kishim marrë. Mashtrim apo nuk e di si e ka konceptuar KQZ këtë...


Av. O. Serani: E kishim marrë, e kishim dorëzuar dy herë për të marrë po të njëjtat pamje filmike duke na thënë që janë në dispozicion. Pasi i kemi parë nuk kanë qenë.

Z. K. Bele: Nuk e di në e kuptova drejtë, ju keni marrë pamje filmike të pa plota apo nuk keni marrë fare?

Av. A. Llangozi: Ne nuk i kemi marrë fare. Jemi gënjyer disa herë, kemi ardhur pranë sporteleve, kam ardhur edhe vetë dy herë, asnjëherë nuk na janë vënë në dispozicion. Ne kemi marrë pamje filmike vetëm qëndrës së numërimit, jo të QV. I kemi kërkuar me 10-tra shkresa dhe emaile nuk kemi arritur ti marrim. Dhe email që është më kryesor, mund ta lexosh të fundit.

Av. O. Serani: “Se së pari, nuk është në praktikën tonë ti dërgojmë Prokurorisë asnjë dokumentacion tjetër përveç formularit të dekriminalizimit. Cdo dokument shtesë që Prokuroria kërkon, ja vendosim në dispozicion në të gjitha rastet”. Kjo ka qenë një kthim përgjigje kur është bërë një email pse nuk është vënë në dispozicion Prokurorisë vendimi i dënimit të zotit Kreshnik Hajdari. “Së dyti, në shkresën e dërguar për verifikim të thelluar në Prokurori janë shprehur edhe pretendimet e

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

ngritura në kërkesën e koalicionit Bashkë Fitojmë. Së treti, u bëjmë me dije se, ju si Koalicion "Bashkë Fitojmë" na e keni vendosur ne dispozicion këtë vendim, për këtë motiv nuk e gjejmë të bazuar kërkesën për tu dhënë të njëjtin vendim". Ndërkohë që vendimi nuk është vënë në dispozicion nga ana jonë ne kemi qenë përfaqësues të zotit Lefter Maliqi por edhe sikur ta kishim vënë në dispozicion për sa kohë që ne kërkuam një vendim, i cili ndodhet në këtë institucion nuk besoj se ka ndonjë arsye pse të mos na vihet në dispozicion përsëri. Këto edhe një sër kërkesash emaile nëpërmjet ne kemi kërkuar edhe kërkesën për protokoll bashkëlidhur.

Z. L. Maliqi kandidat i BF-së: Edhe një shtesë të vogël meqë është kjo procedurë. Në bazë të ligjit të dekriminalizimit 1/10 e deputetëve i kanë kërkuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për këtë problem, para dy ditësh. Me numër protokoll nga Parlamenti i Shqipërisë edhe janë firmat e 14 deputetëve të Bashkë Fitojmë.

Z. K. Bele: Për çfarë u parashtrua më fal keni gjë për të parashtruar për kërkesat e avokatit dhe kandidatit?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i BF-së: Jam dakord me kërkesat e bëra edhe nga kandidati edhe nga kolegu avokat. Kështu që pse mos të jepen në dispozicion duket që qartazi dhe haptazi është e qëllimshme.

Z. K. Bele: Zoti Merkaj në këtë fazë ju lutem një sqarim. Çfarë nuk ka funksionuar në dhënien e materialit?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

Z. Y. Merkaj: Çdo gjë ka funksionuar, ia kemi dhënë të gjitha materialet brenda 5 minutash nga kërkesa e përfaqësuesve të ankuesit. Në lidhje me kamerat me QV pamjet filmike. Kemi pasur shumë kërkesa ankimore ,kanë qenë 5200 kamera që duhet të transferoheshin të dhënat nga kamera në sistemin tonë ose në hard disqet që kanë paraqitur ankuesit. Janë 5200 herë 12 orë është një kohë shumë voluminoze, megjithatë ne i kemi bërë sipas kërkesave. Kërkesën e parë kemi bërë transferimin e kamerave të kërkesës së parë ankimore. Kjo ka qenë e fundit dhe ka ngelur në fund. Megjithatë komunikoj nga Drejtoresha e IT që këta nuk kanë sjellë një Hard Disk dhe akoma nuk kanë sjellë hard diskun që të hedhim pamjet filmike në hard diskun e tyre. Vazhdojnë akoma edhe sot mos ta sjellin hard diskun në një kohë që të gjitha shpenzimet i ka pala ankuese duhet të sjellë hard diskun e jashtëm me kaq giga bajt sa e kërkojmë neve 8 ose 10 herabajt, nuk i kanë sjellë në këto kushte nuk kemi si tia japim. Nuk është një letër që tia japim në dorë.

Z. K. Bele: E kuptoj jam i qartë se ky diskutim është bërë edhe në kërkesat e tjera ankimore.

Av. A. Llangozi: Kërkesa i nderuar është bërë me datë 26 dhe kemi marrë pamje filmike sepse për këtë them që është personi përgjegjës ky zotëria. Për arsye sepse ne i kemi marrë pjesërisht pamjet filmike kërkesa është bërë në të njëjtën datë. Nuk është bërë me data të ndryshme, është protokolluar në të njëjtën ditë, na është dhënë vetëm qendra e numërimit dhe nuk na janë dhënë QV. Një provë që ne e kemi, kemi pamjet filmike të qendrës së numërimit të votave dhe nuk është i vërtet pretendimi që ngriti zotëria. Kemi çuar emaile të pa fundme dhe madje madje është një zonjë që është këtu tek protokollin , kam ardhur edhe vetë me gjithë kolegen time, bëj kërkesë tjetër, jo i kam thënë i kam dhënë dhe numrin me protokoll. I

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

kam dhënë edhe pajisjen jemi komunikuar sërish hajde merre, e kam marrë edhe kemi marrë të njëjtat materiale. Kështu që nuk është i vërtet ky pretendim që zotëria ngre.

Z. K. Bele: Këtu ku jemi që mos të humbasim rrjedhshmërinë e asaj që po diskutojmë. Në qoftë se unë e kuptova drejtë se kemi pasur këtë praktikë edhe me të parën, me disa kërkesa. Filmimet e KZAZ-ve siç e kuptoi unë dhe siç e shpjegoi dhe sekretari filmimet nga qendrat e numërimit nga VNV-të janë marrë fillimisht pasi ato janë për një arsye të thjeshtë janë 100 qendra në gjithë Shqipërinë. Kurse për 5 mijë ose sa janë fiks 5200 QV materiali është mbledhur se do kohën e vet që të tërhiqet ai material. Sipas asaj që tha sekretari me respektimin e rreshtit të kërkesave ankimore , ju sjell në vëmendje që Elbasani ka pasur 220 QV ka kërkuar, Kamza 120, pra këto kërkesa janë bërë nga shumë subjekte dhe ata kanë pasur kohën e tyre dhe pretendimet për këtë shkak. Por në fund të procesit përgjithësisht janë marrë, me rastin kur nuk ka punuar është diskutuar edhe ky rast. Tani unë dua të kuptojë sot që ne flasim, është e mundur që këto 64 QV të merren nga pala? Janë në gjëndje ti marrin sot?

*Zbardhi materialin audio
Ardita CAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

Z. Y. Merkaj: Patjetër janë në gjendje, po nuk sollët harddisc-un e jashtëm nuk e marrin dot, duhet të sjellin harddisc-un që ta marrin. Ta sjellin harddisc-un, ta depozitojnë te protokollin, të flasin me IT-në sa orë i duhet IT-së ta hedhi dhe kaq, është e thjeshtë.

Z. A. Llangozi: E kemi gati, e kemi sjellë tre herë, tre here, dhe çdo ditë i kemi sjellë email që kemi qënë këtu. Duhet të na i provojë zotëria se unë kam pamjet filmike që i ka parë pjesërisht.

Z. K. Beke: Ta marri protokollin tani. Po.

Z. L. Braho: Zoti Merkaj, ju te këto email-et që i keni dërguar ja keni kërkuar këtë harddisc-un e jashtëm?

Z. Y. Merkaj: I kemi kërkuar një shkresë tjetër, për një përgjigje tjetër, jo për harddisc-et.

Z. L. Braho: Po pjesa e konstatimit të mungesës së harddisc-ut, nëqoftëse këta siç thoni ju nuk e kanë sjellë asnjëherë, ja keni prapësuar ndonjëherë me përgjigje, me email, me ndonjë shkresë?

Z. Y. Merkaj: Ka qënë në kontakt drejtoresha e IT-së pothuajse çdo ditë, çdo ditë i thotë hade sill harddisc-un. Tani me një person që është dënuar për fallcifikim dokumentash, s'mundem të komunikoj...

Z. L. Braho: Zoti Merkaj, tani t'i lëmë këto.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

Z. Y. Merkaj: Është dënuar me vendim gjykatë.

Z. L. Braho: T'i lëmë këto, tani unë po them edhe njëherë

Z. Y. Merkaj: Tani ai më akuzon mua drejtpërdrejtë unë mos ta akuzoj me fakte?
Me vendim gjykatë, me vendimin e gjykatës?

Z. L. Braho: Tani ti je përfaqësues i një institucioni shtetëror këtu, nuk ka, edhe njëherë, nuk po bëjmë gjyqin, këtu po shqyrtohet administrativisht kërkesa ankimore që kanë paraqitur palët, dhe pala ka bërë një kërkesë, dhe unë mendoj që normaliteti do ishte që për çdo mangësi që ka patur kërkesa si çdo institucion shtetëror, KQZ-ja duhet t'i kthente përgjigje zyrtarisht jo verbalisht, aq më tepër me këto pretendime.

Z. Y. Merkaj: Ka patur shumë kërkesa ankimore, ka patur ndonjë kërkesë për dhënien e këtyre? Kemi qenë gjithmonë të hapur nuk është se kemi fshehur asgjë. Ka qenë koha fizike e pamundur. Ka qenë kërkesa e fundit ankimore, është e fundit në rradhë për të transeruar të dhënat, është e thjeshtë gjëja.

Znj. O. Serani: Mund të sqarojmë diçka të lutem, duke qenë që korespondencën dhe me email-e dhe për paisjen e kam patur unë, kam ardhur tre herë, e kanë depozituar paisjen, më kanë thënë që janë pamjet filmike, shkuar në zyrë, kam hapur paisjen, kam parë që nuk kanë qenë pamjet filmike, e kam riardhur përsëri. Ditën e djeshme po ashtu i kam dërguar një email dhe i kam thënë: ju bëj me dije se në datën 26.05.2023 kanë depozituar pranë KQZ-s kërkesën t'u pajisur me pamjet filmike për të gjitha qendrat e votimit, për zgjedhjet e 14 majit dhe kërkesa mban numër 5571 protokolli. Aktualisht është data 7.06.2023 dhe ende nuk na janë vënë në dispozicion

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

pamjet filmike të qendrave të votimit. Unë avokate Orgesa Serani, në cilësinë e përfaqësueses ligjore të kërkuesit Lefter Maliqi, jam paraqitur pranë zyrës së protokollit, kam depozituar pajisjen për të marrë pamjet filmike dhe më rezultoi se më ishin vënë në dispozicion vetëm pamjet filmike të qendrës së numërimit dhe tavolinave të numërimit. Kam ardhur përsëri, më është kërkuar të depozitoj kërkesën përsëri dhe të risjell përsëri pajisjen për të marrë pamjet. Pasi kam marrë pajisjen kam konstatuar se përsëri nuk më kanë vënë në dispozicion. Nuk e kuptoj aspak këtë sjellje të institucionit tuaj, që kam 10 ditë që merrem vajtje ardhje për të marrë pamjet filmike dhe nuk më janë vënë akoma në dispozicion. Mbas këtij email-i asnjë përgjigje.

Z. K. Bele: Është email-i i datës 6.

Znj. O. Serani: Po, i djeshmi, i datës 7, se kam çuar prapë në datën 7.

Z. K. Bele: Dakord, është i njëjti email, është ridërguar në datë 7. Unë lexova këtë ndoshta e shoh në datë 6, nejtë. Po është i ridërguar, po, dakord. Mirë.

Z. Y. Merkaj: Mund ta thërrasim drejtoreshën e IT-së sepse unë nuk kam qënë në komunikim asnjëherë me këto.

Znj. O. Serani: Kur s'ke qënë në komunikim me IT mos abuzo.

Z. Y. Merkaj: Ta thërrasim drejtoreshën e IT-së të na tregojë si është.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

Z. K. Bele: Më falni një minutë, të kthehemi te çështja dhe të merremi me themelin, me pretendimin e zgjedhjeve. Këtu ka çeduar procesi i shkëmbimit të materialeve, besoj e kuptoni volumin dhe faktin që KQZ-ja ka qënë e mbledhur çdo ditë si në procese administrative të natyrës tjetër që kanë patur të bëjnë me shaplljen e vendimit të tabulimit, ashtu dhe kërkimet ankimore në KAS, kështu që unë e kuptoj drejtë shqetësimin tuaj për kërkimin e dokumentave, por kërktoj gjithashtu mirëkuptimin dhe të kthehemi te fakti, pra ato pamje atje ku janë do ju vihen në dispozicion dhe ne do vazhdojmë procesin me pretendimet e tjera, ndërkaq kemi kërkesën tuaj për të cilën ne duhet të shohim.

Z. L. Maliqi: Mos mendoj, mos jam unë shkak që s'janë dhënë dokumentat, sepse e ngriti si problem prandaj.

Z. K. Bele: Mos i hymë këtij debati, jo. Relatojmë që ka ardhur avokati.

Z. M. Legisi: Mariglen Legisi i nderuar. Ju kërkojmë ndjesë për vonesën

Z. K. Bele: Po ishim në dijeni që ishit në një proces tjetër dhe e lamë që në momentin që do vinit të.....

Z. A. Kaziaj: A mundet zoti relator vetëm një saktësim. Ju dhe Sekretari i Përgjithshëm thatë që fitet për 5200 qendra votimi, normalisht këto janë qendrat e votimit, por fakti është se nuk janë të gjitha objekte ankimi, ato qendra apo ato bashki. Ne po kërkojmë ato që janë objekt ankimi, dhe në momentin që me prova disponohet që për objektin e ankimit për Bashkinë Kuçovë, për KZAZ-në 64, është bërë një kërkesë, normalisht me gjithë ngarkesën që mund të ketë KQZ-ja, siç e thatë dhe ju

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

çështja ka natyrë kohe, ka natyrë që duhet të shprehemi dhe ju në një afat kohor shumë të shkurtër. Ne akoma nuk disponojmë të gjitha materialet për të krijuar idenë dhe për të bërë një mbrojtje sa më efektive në të mirë të atij që përfaqësojmë, dhe del pengesa tani dhe merremi dhe me çështje personale. Ju lutem ju të vendosni në lidhje me disponimin sa më të shpejtë të këtyre pamjeve filmike.

Z. K. Bele: Zoti avokat, e kisha që 5200 qendra duan kohë të merren nga KQZ-ja, nga firma, siç e kam kupëtuar unë, pastaj secili ankues do marri atë që do dhe në këtë proces çdo provë që ka qënë në posedim të administratës dhe është kërkuar nga pala, në përpjekjen tonë më të mirë, përveç shkaqeve të natyrave teknike ose kur s'kanë qënë të mundura ato, janë vënë palëve në dispozicion dhe kjo ka sjellë dhe ndoshta zgjatjen e këtyre proceseve, megjithëatë ne nuk do debatojmë për këto. Ne kemi një kërkesë të avokatit për të cilën ne do duhet të shprehemi, kështu që ne po tërhiqemi të shprehemi për themelin e kërkesës, ndërkaq do marrim dhe informacionin për pajisjen nëse është funksionale dhe sa kohë do të dojë që të kalohen të dhënat.

Z. Y. Merkaj: Drejtoresha IT mund ta shpjegojë më mirë.

Z. K. Bele: Nuk na duhet çfarë ka ndodhur.

Z. Y. Merkaj: Më duhet mua. Po bëj pra se po më akuzojnë që s'i kam dhënë përgjigje.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

Z. A. Llangozi: Ka ardhur nga emaili prandaj, tani emaili i zotërisë është, tani ne nuk e dimë sesi funksionon tani. Gjyqi im është bërë, tani gjyqi Sekretarit mund të bëhet.

Z. K. Bele: O avokat, të lutem flasim me rradhë, do flasim me rradhë. Drejtoreshë kemi një kërkesë për marrje informacioni, është kërkuar dhe harddisc-u, të lutem verifikohe nëse harddisc-u është funksional dhe sa kohë do që të merret ky informacion.

Znj. D. Alimemeti: Unë e kam sqaruar, me zonjën kam folur dje, e kam sqaruar që është bërë gati kërkesa, pas nxjerrjes së pamjeve filmike të elbasanit, janë vënë në proces Kuçova dhe ishte gati, po prisnin vetëm harddisc-un.

Z. K. Bele: Kur ka qënë gati?

Znj. D. Alimemeti: Domethënë do të bëhej gati, sot në mëngjes do të mbyllej procesi.

Z. K. Bele: Dakord. Pra nuk ka të bëjë me vullnete të munguara por ka të bëjë me afate kohore fizike.

Z. A. Llangozi: Po vendimi i dënimit a është vullnet i nderuar? Zotërinj, vendimi i dënimit të kandidatit Kreshni Hajdari, është vullnet apo s'është vullnet? Është vullnet sepse e ka kundërshtuar, ndoshta se ka kundërshtuar zotëria por e kanë kundërshtuar të tjerë.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

Z. K. Bele: O avokat, jemi te

Znj. O. Serani: Zotëria e ka kundërshtuar se email-in e ka kthyer zotëria.

Z. K. Bele: Të lutem, o zonja avokate, se nuk mund ta bëjmë dialog gjithë kohën. Jemi te vendimi, ne po tërhiqemi për vednim, kështuqë do t'ju thërrasim për 10 minuta apo dhe më shpejtë nëse s'do kemi.

Mirë KAS në përfundim të, mbasi u konsultua, vendos pranimin e pjesshëm të kërkesës duke vendosur në mbështetje të nenit 21/2 të Kodit Zgjedhor administrimin në këtë proces të provave materiale filmike, dokument si dhe çdo material zgjedhor që administrohet nga KQZ dhe që do të vlerësohet i nevojshëm në proces. Rrëzimin e kërkesës për vendosjen e sekuestros të provave të kërkuara, pasi nuk parashikohet në Kodin Zgjedhor si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, kompetenca e KAS për vendosje të sekuestrove. Në mbështetje të nenit 130 të Kodit të Procedurës Administrative ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim bashkë me vedimin përfundimtar. Gjithashtu sqarojmë meqënëse jemi në seancë, duhet të kemi parasysh që KAS në vetvete nuk funksionon si trupë e shkëputur, nuk ka një administratë të vetën dhe nuk administron KAS-i prova, kuti, materialesh, apo çdo lloj materialesh filmike apo çdo gjë tjetër. KAS në aktivitetin e tij, udhëhiqet, ndihmohet nga administrata e KQZ-së e cila bën detyrat si pjesë e integrale, pasi jemi pjesë e të njëjtit organ. Gjithashtu ju sjell në vëmëndje që në Kodin Zgjedhor është një nen i caktuar, që përcakton rregulla strikte për ruajtjen e dokumentacionit, është detyrim i KQZ-së të ruaj dhe të administrojë çdo lloj dokumentacioni zgjedhor përfshirë dhe atë që kanë prodhuar dhe pajisjet PEI apo pajisjet e tjera dhe asgjesimi i këtij dokumentacioni bëhet sigurisht me vendimmarrje dhe procedura të caktuara. Kështu që në këto kushte ne do t'i marrim në proces ato që kërkohen nga ana juaj, por thjesht

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

nuk mund t'i mbajmë ne këtu si KAS, por do jetë pjesë e shqyrtimit dhe patjetër do tu jepen kopje palëve për çfarë kërkohet. Desha vetëm të informohem nëse u kuptua në këtë fazë mundësia e marrjes së pamjeve filmike, pra është e mundur që ato pamje filmike, nuk e di Ylli, drejtoresha, jo jo, duke qënë se ja ngarkuam drejtoreshës të verifikonte, se mund të dali, një rast tjetër na doli, nuk e di çfarë ankimi, na doli që USB-ja nuk e merrte, shkante deri në gjysmë e kthente mbrapsht. Pra u ferifikua që...

Z. Y. Merkaj: Sapo u njoftova nga drejtoresha që tani e kanë blerë një harddisc të ri dhe sapo e kanë sjellë një harddisc të ri.

Z. K. Bele: Dakord, pra kemi mjetin i cili do të, sa kohë mund të dojë dhënia e këtyre materialeve, nëqoftë se e ke idenë?

Z. Y. Merkaj: Ndoshta 24 orë pëer t'i hedhur. Është proces shumë i gjatë prandaj po them....

Z. K. Bele: Pse bëhet manualisht çdo kamer?

Z. Y. Merkaj: Po, është koha fizike që nuk ta lejon ta bësh më shpejt. Janë 12 orë video.

Z. K. Bele: Më fal ju këtu, në këtë fazë, ju keni kërkesë për të 64 qendrat, apo doni qendra të veçanta?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

Z. A. Llangozi: Ne kemi bërë gati stafin dhe nuk është se do ju vonojmë. Në momentin që ne do marrim pamjet filmike do kërkojmë të paktën 3 ditë kohë që ne t'i kqyrim të gjitha pamjet që përderisa kemi ngritur problemin e pavlefshmërive është një e drejtë e jona që ne këto akte, se këto janë akte që garantojnë procedurën e zgjedhësve, më saktë këto janë procesverbale që quhen, ashtu siç është dhe dokumentimi me audio në këtë proces, këto janë procesverbale reale të të gjitha qendrave të votimit dhe për këtë ne mendojmë që do kërkojmë t'i kqyrim të gjitha ato pamje.

Z. K. Bele: Dakord, ndoshta ato meren që sot, tani lidhur me vazhdimin e seancës, doni të vazhdoni me parashtrimet në këtë fazë në lidhje me çfarë keni ngritur apo kërkonit dhe... më fal para se të shtrojë pyetjen si është proceduar për të ndihmuar dhe procesin, pasi ne bëjmë të njëjtën gjë, në proceset e tjera palët kanë paraqitur pretendimet e tyre duke çelur në këtë mënyrë procesin, pasandaj në paraqitjen e provave kanë disponuar për provat që kanë pasur në dispozicion, siç janë ato që ju mund të keni, dhe ndërkaq për prova të tjera të cilat janë marr në këtë formë siç janë materialet. filmike apo një dokument i cili kërkohet nga pala në proces, ju kemi të drejtë që sigurisht do kërkonit kohë, gjatë seancës të shtoni pretendimet dhe gjetjet tuaja për provat, nëse keni të tilla.

Z. A. Llangozi: Në kërkesën që ne ju parashtruam ndoshta nuk e keni konstatuar faktin që ne kemi kërkuar te merret në cilësinë e provës edhe vendimi i dënimit të shtetasit Kreshnik Hajdari.

Z. K. Bele: Nuk shprehet trupi gjykues, pasi është dhe kjo pjesë psh ne pjesët e ankimeve mund t'i marrim me rradhë dhe mundet të vijojmë. Thamë të të gjitha

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

dokumenteve shkresore dhe materialeve zgjedhore që administrohen nga KQZ-ja, dhe për sa kohë që kjo administrohet nga KQZ do të merret nga ana juaj, mesa kam parë unë materialin, ju e keni cituar përmbajtjen e këtij materiali, mbase është i njohur për palët, megjithatë ne do kërkojmë të vijë një kopje nga KQZ-ja për të qënë pjesë e këtij procesi dhe dokumentat që vijnë dhe sillen në proces ju jepen dhe kopje palëve, besoj kjo e kënaq...

Z. A. Llangozi: Unë mendoj dhe jam i qëndrimit, atë e vlerësoni ju në lidhje me ecurinë e gjykimit, unë jam i mendimit që ne të marrim edhe pamjet filmike që të krijojmë një vizion të qartë dhe medoj që ne brenda një dite e përfundojmë të gjithë procesin, që nuk do kemi as mungesë dhe as...

Z. K. Bele: Për procedurë avokat, si në çdo lloj gjykimi, ju bëni fjalën tuaj hapëse, parashtroni pretendimet në mënyrë të përmbledhur dhe për provat marrim kohë, ndërkaq merrni provën dhe merrni kohën e nevojshme për të laburuar gjërat shtesë që ju do keni.

Z. A. Llangozi: Të nderuar, duke qënë që procesi zgejdhor është një proces i cili duhet të ketë garë të barabartë midis dy kandidatëve që është Kreshnik Hajdari në rastin aktual dhe shtetasi Lefter Maliqi, klient që përfaqësohet nga unë, dhe duke iu referuar pozitës që shtetasi Kreshnik Hajdari ka patur detyrën e Kryetarit të Bashkisë në Bashkinë Kuçovë, rezulton se gjatë procesit ky shteta ka shfrytëzuar resurset dhe buxhetin e shtetit në lidhjet për të krijuar një pozitë të pabarabartë midis kandidatit tjetër kundërshtar. Ne i nderuar kemi pamjet filmike, që nuk e di nëse do mundësohet se do vijojmë me këtë pjesë, mendoj që do e ezaurojmë këtë fakt, kemi pamje filmike të cilat ne provojmë që shtetasi Kreshnik Hajdari ka shfrytëzuar buxhetin e bashkisë

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

për të bërë një garë të pabarabartë me shtetasin Lefter Maliqi. Ai ka shfrytëzuar të gjithë biznesmenët të cilëve ju kishte dhënë tendera në kundërshtim me ligjin për konfliktin e interesi, sepse të gjithë këto biznesmen duke filluar nga subjekti Salillari SHPK, Mara SHPK, ka marrë përsipër që të bëjë një reklamë në mënyrë të padrejtë në lidhje me kandidatin e tyre. Të dy këto subjekte kanë vijuar duke shtruar çakull pothuajse në të gjitha rrugët e Bashkisë Kuçovë. Ky veprim siç e theksova është dhe i padrejtë, është i padrejtë sepse panvarësisht se bashkia ka marrë një dhuratë, por edhe kjo dhuratë që ajo ka marrë duhet ta merrte me procedurë, duhet të kishte një procedurë dokumentimi për të gjitha veprimet që janë bërë. Por duke u ndoshur dhe në fazën zgjedhore dhe Kodi Zgjedhor e përçakton qartë që kandidatët nuk duhet të marrin përfitime qoftë dhe nga pesona të tretë, qoftë dhe buxhetin e shtetit ata nuk duhet që ta shfrytëzojnë për këtë, për qëllime të fushatës, përveç kësaj shtetasi Kreshnik Hajdari, ka vënë në dispozicion të fushatës së tij të gjithë administratën, të cilën e kemi të dokumentuar. E ka vënë në dispozicion të zgjedhjeve dhe këto sjellin një ndikim në mënyrë të drejtëpërdrejtë te zgjedhjet e lira. Shtetasi Kreshnik Hajdari ka bërë tendera në kundërshtim flagrant me ligjet e republikës së Shqipërisë dhe me Kodin Zgjedhor, sepse është përcaktuar në mënyrë taksative që 4 muaj përpara se të fillojë, 4 muaj para datës së zgjedhjeve, nuk mundet që ky shtetas të krijonte tendera dhe të hapte tendera të tjera për bashkinë. Kjo gjë nuk ka ndoshur, ne kemi bërë kqyrje të facebook-ut të shtetasit Kreshnik Hajdari, i cili gjatë gjithë kohës reklamonte gjithë punimet që ishin duke u kryer në ato momente. Ai ka vijuar dhe ka bërë një fushatë me të gjithë buxhetin e shtetit, duke filluar nga shkolla, nga rrugë të cilat shtroheshin prej buxhetit të shtetit dhe që ishin shtruar, nuk e di sesi ka funksionuar domethënë, s'ka një procedurë të deklaruar sesi ka vepruar. Pra të gjitha këto kanë sjellë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndikim te vota. Kemi disa kilometra rrugë të asfaltuara nga subjekti Salillari SHPK, për të cilat janë bërë dhe kallximet

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.8.06.2023*

përkatëse në SPAK, aktualisht të gjitha këto kallxime, janë rreth 4 kallxime të bëra për subjekte të cilët investoheshin duke bërë një propagandë të padrejtë, një garë të pabarabartë. Kërkojmë që të kqyren këto pamje, kjo është përsa i përket një pjese të shkakut të pavlefshmërisë që ne do ta ngremë përpara këtij trupi gjykues. Pamjet i kemi, ne kërkojmë t'i vëmë në dispozicion , do t'i shpjegojmë. Po, është kopje për ju, njëkohësisht unë i kam edhe në USB-në time që do t'ua shpjegoj hap pas hapi. Mendoj që duhet ta filloj, qëllimi është se, shpesh dëgjoj që KAS-i është politikë, shpesh dëgjoj që KQZ-ja, ju jeni institucion dhe mendoj që duhet të merret një vendim që edhe për opinionin publik të krijohet një ide ndryshe. Nuk mund të funksionojë që të zgjidhen disa persona të cilët janë politik dhe duhet të marrin vendim gjithmonë politik. E drejta është ajo që është, është e dokumentuar, ne e kemi dokumentuar hap pas hapi dhe në shumicat, ditën e votimit, shumë nga punonjësit e bashkisë janë konstatuar të cilët shoqërojnë, çojnë ndihma, shoqërojnë persona me aftësi të kufizuar, votojnë ata për persona të tjerë dhe kjo është e dokumentuar me pamje fimike.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

Z. L. Maliqi: Kam një ndërhyrje të vogël, meqënëse jam personi që kam bërë kallzimin drejtpërdrejt në SPAK, nuk janë bërë të gjitha me procedurë tenderimi nga bashkia por çaku nga firma Salillari nuk është fare në procedurë pra është nga firma e tij private dhe janë dërguar dhe nga qytetarët nga banorët firma kontraktore, pra një e çonte tek mjetet e vet një të firmës nënkontraktore në zona, janë bërë mbi 50 km rrugë çaku dhe është bërë asfalt mbi asfalt, për të cilin ka kallzim të veçant në një zonë të madhe me 1000-2000 votues.

Z. A. Llagnozi: Ne kemi në cilësinë e provës dhe 8 publikime në media të ndryshme online që kanë publikuar dhe kanë denoncuar këtë fakt, janë me shkrim por ne i kemi dhe me audio me video njëkohësisht në USB-në përkatëse, i sjellim dhe këto në cilësinë e provës që të jenë. Do ta vëmë për këqyrje unë do t'i shpjegoj të gjitha pamjet 1 nga 1, edhe çfarë provojmë me këto prova.

Z. K. Bele: Nëse ju do të kemi dhe prova të tjera audio ose mund të keni prova të tjera audio, video që do provohen nga kamerat në seancën ku do debatojmë për provat ne i marrim ato dhe i shikojmë, pra bëjmë prezantimin paraprak të kërimit tuaj, dëgjojmë dhe palët mos kanë ndonjë kërkesë tjetër dhe pastaj në seancën tjetër ne bëjmë, ndërkaq edhe ne kemi kohën të njohemi me këto...

Z. A. Llagnozi: Atëherë po fillojmë që nga momenti i fillimit të kandidimit të dy kandidatëve, në KQZ në bazë të ligjit 138, 2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen dhe emërohen ose ushtrojnë funksionet publike, 2 kandidatët kanë patur detyrime ligjor që në KQZ të depozitonin dokumentacionin përkatës dhe ka qënë detyrim ligjor që të depozitohej një formular dekriminalizimit

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

ku shprehej vullneti i kandidatit të Bashkisë Kuçovë dhe njëkohësisht kandidatit tjetër të Bashkisë Kuçovë Koalicioni Bashkë Fitojmë, që është zoti Lefter Maliqi dhe zoti Kreshnik Hajdari, rezulton se në formularin e dekriminalizimit të cilin ne e kemi në cilësinë e provës, e kemi marrë nga KQZ-ja këtë formular në formën e kërkuar me vulë përkatëse është një provë që është dhënë, rezulton se shtetasi Kreshnik Hajdari ka pasqyruar të dhëna të pavërteta të cilat rezulton se ka mashtruar, ka kryer veprime në mashtrim të ligjit i cili është parashikuar në nenin 92 Kodit Civil, ishte një debat që ju si KAS e keni rëzuar këtë është lënë detyrë nga gjukata, nga Kolegji Zgjedhor që kjo duhet të gjykohet. Pse duhet të gjykohet? Çfarë është ky formular? Ky formular është shprehje e vullnetit të lirë të një kandidati për kryetar bashkie, ajo është një lloj si kjo kërkesë që unë paraqes përpara jush, si ankimi administrativ. Ankimi administrativ në vetëvete është një vullnet dhe është një veprim juridik të cilin unë e paraqes përpara jush, edhe jo pa qëllim ju keni patur seancën paraprake për të dokumentuar nëse plotësohesh ana formale e këtij dokumenti apo jo. Pra ankimin administrativ që unë kam paraqitur përpara jush, që do të thotë veprimin juridik që unë kam kryer dhe vullnetin juridik që unë kam paraqitur, ju e gjykuat si një veprim juridik të vlefshëm dhe e keni kaluar në seancë, atëherë të tjera veprime juridike që ju si KAS jeni duke gjykuar në këtë proces, veprimi juridik është prokura që unë kam paraqitur përpara jush është një akt i shkruar e kemi të përcaktuar edhe në prokur, që kjo prokurë është formuar edhe në bazë të Kodit procedurës Civile edhe në bazë të vullnetit të personit, që është shtetasi Lefter Maliqi, pra nëse kjo prokurë do të ishte e paligjëshme atëherë kjo do të ishte konstatuar nga ana juaj dhe unë nuk do të isha legjitimuar, pra ky Kolegj edhe pse Kolegji Zgjedhor ja ka lënë detyrë dhe ka konstatuar që kjo pjesë e këtij ankimi do të gjykohet nga ana juaj sepse ju jeni


*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

kompetent unë e shpjegova dhe me mjete të tjera të cilat unë i kam kërkuar përpara këtij trupi gjykues, që janë ankimi, prokura e të tjera. Edhe mendoj se jeni kompetent për ta gjykuar këtë rezultat. Rezulton se, në tre pika të formularit të dekriminalizimit rezultojnë se janë të pavërteta, janë të pavërteta në pikën ku... kemi pikën 1: Ajeni dënuar ndonjëherë me denim gjyqësor të formës prerë nga autoritet gjyqësor Shqipëtar apo i huaj? Vullneti i shtetasit Kreshnik Hajdari ka qënë jo, ndërkohë ky vullnet nuk ka qënë i drejtë, ka qënë fiktiv dhe këtë ne e provojmë me vendim, pavarësisht se nuk na e ka dhënë në dispozicion dhe ne e mendojmë dhe i qëndrojmë asaj ideje që KQZ e ka fshehur, ne jemi investuar dhe jemi drejtuar gjykatës së Janinës, ne në cilësinë e avokatëve dhe kemi marrë vendimin e dënimit të këtij shtetasi, me vulën apostile përkatëse, që është në origjinal, e kemi edhe në origjinal që nëse KAS e vleron, ne e kemi të noterizuar këtë, nëse e vleron që duhet origjinal ne e paraqesim edhe në origjinal dhe na rezulton se me vendimin me 3286, datë 23.06.1999 shtetasi Kreshnik Hajdari ka qënë dënuar me katër muaj burgim në këtë shtet dhe ka rezultuar që pika 1 e këtij formulari është e pavërtetë dhe është një veprim juridik fiktiv i kryer në mashtrim të ligjit sepse ligji thotë që, duhet të trgoth të vërtetën ndërkohë ky shtetas ka mashtruar me ligjin. Njëkohësisht ky shtetas ka paraqitur të dhëna të pavërteta në pikën 3, të formularit të dekriminalizimit i cili përcakton në mënyrë të qartë se ka qënë apo jo ndonjëherë në hetimnë gjykim nga një autoritet i huaj, fakt ky që vullneti i shtetasit Kreshnik Hajdari ka qënë jo, ndërkohë me vendimin përkatës të mësipërm ne i provojmë këtij Kolegji që ky shtetas ka qënë i dënuar dhe në hetim njëkohësisht ka qënë edhe në gjykim dhe nëse ne i referohemi vendimit në faqen e parë të tij, direkt mbas pjesës hyrëse të vendimit gjykata thotë, vendosi të dënohej në prani të të akuzuarve, pra shtetasi Kreshnik Hajdarika patur djeni në mënyrë të

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

drejtpërdrejtë që ka qënë i dënuar sepse ka qënë në prani ka qënë prezentë në atë proces dhe për këtë arsye nuk e ka deklaruar dhe e ka bërë me qëllim mashtrimin e ligjit, njëkohësisht a ka qënë i ndaluar është në pikën 4, për ndonjë veprë penale gjë që shtetasi Kreshnik Hajdari ka thënë jo, ndërkohë nga këqyrja e facebook-ut të këtij shtetasi, në moment që ky skandal plasi në media, e ka pranuar në facebook-un e tij që ka qënë njëherë i ndaluar në shtetin Grek, e ka pranuar dhe kjo është dokumentuar nga ana jonë të cilën ne do ta vëmë në dispozicion trupit gjykues. Cilësin e provës në këtë pikë që ne kemi ngritur si pavlefshmëri veprimi juridik ne, kemi sjellë dy dokumenta që është akti i cili ne, kërkojmë të konstatohet si i paligjshëm njëkohësisht ne kemi edhe vendimin e dënimit të këtij shtetasi, që është me vulë apostile pavarësisht se me shtetin Grek nuk ka nevojë që të jetë dokumenti me vulë apostile, por ne e kemi marrë me vulë apostile që të ketë një fuqi më të lartë detyruese për institucionet e shtetit Shqiptar, kemi vendimin ku provohet që ky formular dekriminalizimi është ia pavërtetë fiktiv dhe në mashtrim me ligjin. I kam këto dy dokumenta të cilat do t'i paraqes, pra filloj gara, gara filloj në mënyrë të pabarabartë që shtetasi Kreshnik Hajdari futet në kundërshtim me ligjin në këtë proces zgjedhor, e kemi të provuar. Kemi të provuar faktin tjetër me pamjet filmike që ju keni sjellë, që ky shtetas edhe vetë në faqen e facebook-ut herë pas here reklamonte, atë punë edhe ato investime të cilat ai i bënte në kohë fushate, është e provuar jo vetëm nga media të ndryshme por është e provuar edhe nga vetë Kreshnik Hajdari i cili i ka të pasqyruara në proces, këto janë përsa i përket garës dhe fillimit të garës . Ndërkohë në lidhje me procesin zgjedhor kemi ngritur problemin që kërkojmë pavlefshmërinë, konstatimi i pavlefshmërisë së vendimit KQZ, ku është emëruar Sekretari i KZAZ 64, për këtë pikë heqim dorë sepse nga KQZ na është dhënë dokumentacioni përkatës dhe na rezulton se ky shtetas

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

plotëson kriteret për të qënë, se ne kemi konceptuar që nuk i plotësonte nga informacionet që kishim marrë, por nga dokumentacioni që na është vënë në dispozicion nga KQZ e plotëson. Për këtë pikë ne do heqim dorë, mund ta shprehi vullnetin edhe klienti im se unë jam avokat flas për...

Z. L. Maliqi: Nga verifikimet tona ky është inxhinier naftë dhe profesionin e juristit nuk e ka ushtruar asnjë ditë, ka mbaruar tek UFO apo tek Kristal-i, por që nuk e ka ushtruar si profesion asnjë ditë, në asnjë vend. Në lidhje me kërkimet e tjera ku ne kërkojmë pavlefshmërinë e pjesëshme të fletës së votimit së kandidatit për kryetar Bashkie Kuçovë Kreshnik Hajdari na rezulton se ky shtetas përderisa ka fallcifikuar formularin e vetëdeklarimit kemi një pasojë, që ky shtetas duhet të ishte përjashtuar nga gara dhe nuk duhet të ishte pjesë e fletës së votimit. Por KQZ edhe pse e ka pastur dokumentacionin përkatës nuk e ka bërë këtë veprim është mjaftuar me një kërkesë që i ka bërë prokurorisë së përgjithshme, kjo shkresë që...

Z. A. Kaziaj: Vetëm një moment ju lutem, unë kam një urgjenc dhe më duhet të largohem, ju e dini fare mirë qëndrimin, për shkak se parashtrimet e mia i kam dhënë që në seancën paraprake.

Z. A. Llangozi: Atëherë ne, kemi kërkuar edhe pavlefshmërinë e vendimit të KZAZ, ku KZAZ numër 64, ka marrë vendim që do të shtyhet numërimi i votës nga ora 11:00 deri në 12:30, ky vendim është absolutisht i pavlefshëm për arsye sepse KZAZ nuk vendos dot në lidhje me orarin e numërimit, por është KQZ ajo e cila vendos për orarin e numërimit, por do të thoni ju se çfarë pasojë ka sjellë ky akt që ne e kërkojmë pavlefshmërinë absolute, ky akt ka sjell pasojën e

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

manipulimit total të kutive të votimit. Pse? Sepse nga pamjet filmike që unë kam marrë pranë KQZ që kanë të bëjnë me ruajtjen e kutive të votimit, nëse ne i referohemi pamjeve filmike të cilat sërish ne i kemi në cilësinë e provës dhe do t'ju u vëmë në dispozicion, kutitë në asnjë moment nuk kanë qënë të monitoruara ashtu siç ligji dhe rregullorja përkatëse e KQZ-së e përcakton, nëse ne i referohemi gjëndjes reale në fakt, kemi që kutitë kanë patur një dalje, një derë të jashtëme që është kjo dera këtu dhe palët kanë mundësuar të tjetërsojnë kutitë e votimit, kjo ndoshta është një akuzë shumë e rëndë që ne do të thoni ju... Si e provuat? Ne na lindin dyshime, jo pa qëllim ka dal Kodi Zgjedhor jo pa qëllim është bërë një rregullore e cila garanton që të zhvillohet një proces i rregullt dhe të gjitha vullneti i njerëzve të jetë i garantuar në ato kuti, nëse ne i referohemi faktit që ne ato pamje filmike është skandaloze sepse jo vetëm se këto kuti nuk janë të garantuara dhe nuk janë të monitoruara, gjë që ne na lind gjithë dyshimi edhe fakti dytë është edhe dera e hapur që krijon akses jashtë derës kryesore që ishte, por këto pamje filmike vërtetojnë edhe faktin që ne do të shikojmë hap pas hapi, unë i kam këqyrur, vërtetojnë edhe faktin që nuk kanë funksionuar rregullisht ka ndërprerje, ka ndërprerje sekuencash filmojnë 10 sekonda pastaj kemi 1 minutë shkëputje, do të thotë që nuk garantohet filmimi por edhe këto kuti nuk mbulohen nga kamerat, atëherë referuar sërish këqyrjes së pamjeve filmike të KZAZ-së 64, aty ku janë numëruar votat rezulton se kemi të bëjmë me mbulim vetëm të dy tavolinave të numërimit nga pesë të cilat ishin në dispozicion, pra tre tavolina nuk shikohej fare se çfarë bëhej, nga këqyrja që kemi bërë ne rezulton se numëruesët kanë marrë fletë nga jashtë, të cilët ne do t'i kërkojmë këqyrjen në ato vende që ne e mendojmë ose më sakt që ne kemi konstatuar për mos të marrë pjesë të madhe kohe, vërtetohet plotësisht që kemi të bëjmë me një mos numërim korrekt dhe me

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*


futje të fletëve të votimit në kuti nga jashtë dhe kjo është e provuar e kapur nga kamerat e sigurisë që ishte vendosur, por në asnjë moment kutitë nuk kanë qënë të monitoruara dhe për këtë arsye kjo ne na lind në një dyshim që ne kemi të bëjmë me manipulim të të gjithë procesverbalit.

Z. K. Bele: Këto momente i keni të printuara si të evidentuara veç?

Z. A. Llangozi: Po, i kemi shkëputur me pjesë të vogla të videove përkatëse.

Z. L. Maliqi: Mund të bëjë një ndërhyrje të vogël? Meqënëse kutitë ishin vendosur qëllimisht tek dera e qendrës së Kulturës, kjo derë e Qendrës së Kulturës ishte e lidhur me një derë tjetër me shkollën e mesme në errësirë totale rreth 100 metra, ne e kishim parë si problem këtë dhe kishim njoftuar edhe OSBE/OHDIR unë e kam njoftuar për këtë problem dhe në orën 11:00.....

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

Z. L. Maliqi: Trupit të Kolegjit Zgjedhor dihet, për të cilët, kisha paragjykimet e mia, por kam një vlerësim maksimal për paanshmërinë dhe për drejtësinë që ata dhanë, sepse unë hodha idenë që kjo oligarkë që mori përsipër gjithë këtë proces të përfshirë me korrupsion, e të gjitha me radhë, për të cilën unë kam bërë kallëzim, janë edhe bisedat telefonike, unë i kam kallëzuar në SPAK, me drejtues edhe të KQZ-së, edhe të Prokurorisë së Përgjithshme që thotë: “këtë e marr unë përsipër”, kështu që besoj dhe shpresoj që kjo gjë të shikohet me transparencë nga ana juaj. Faleminderit!

Z. A. Llangozi: Nga hetimi që ne kemi bërë në kuadrin e ligjit “Për avokatinë” na ka rezultuar se, nga materialet zgjedhore pikërisht dokumenti KQV: 3929; 3517; 3525; 3527; 3528; vendimi 101, që është miratuar lista, tabela përmbledhëse, na ka rezultuar që janë të falsifikuar dhe nuk janë bërë konform ligjit. Të gjithë këto dokumenta janë shkruar dhe nënshkruar nga i njëjti person. Këtë ne e kemi bërë me akt ekspertimi që është një provë shkencore, jemi investuar, e kemi dhe aktin e ekspertimit përkatës, të cilin do ta depozitojmë në cilësinë e provës në këtë proces. Njëkohësisht në lidhje me gjithë problematikën që ka pasur, kemi dhe një denoncim publik, të cilin e kemi depozituar me usb-në përkatëse, ku një person pretendon se është dhënë urdhër, që ka qenë pjesë e KZAZ-së, Kuçovë, pretendon se është dhënë urdhër për zhdukjen e procesverbaleve nga kutitë, e procesverbaleve origjinale, për mbylljen e kutive, nga kutitë përkatëse, të cilat i kemi depozituar si provë pranë jush, dhe në përfundim të kësaj video, duket qartë që janë një sërë procesverbalesh origjinale të grumbulluar ku provohet, se nuk ndodhen në kutitë e votimit, por ato procesverbale ndodhen diku tjetër, aty ku është dhënë urdhër që janë zhdukur. Pra, pak a shumë këto janë problematikat, të cilat ne i kemi ngritur, kemi vula, janë konstatuar gjatë procesit të numërimit, kuti pa vula, janë konstatuar mungesë

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

procesverbalesh, të cilat janë shënuar në librat përkatës dhe janë kundërshtuar nga vëzhguesit e shtetasit që përfaqësonte kandidatin Lefter Maliqi. Të gjitha këto prova dhe ato që citohen në lidhje me përmbajtjen e fakteve dhe problematikave të ankimit, e lexoi dhe avokati tjetër i koalicionit Bashkë Fitojmë, janë të njëjta rrethana dhe të njëjtat prova. Por prova më e rëndësishme që ne do t'i kërkojmë këtij kolegji: hapjen e të gjitha kutive për t'u vërtetuar fakti, nëse janë apo jo procesverbalet origjinale të mbylljes së kutive, sepse na rezulton e provuar që nuk janë, na rezulton e provuar që është dhënë një urdhër për zhdukjen e tyre dhe duket qartë në një video ku procesverbalet origjinale ndodhen diku tjetër dhe jo në kutitë e votimit. Aty ne do bëjmë edhe një mbrojtje tjetër në lidhje me kutitë dhe në lidhje me videot, të cilat ne kemi ngritur pretendime që është votuar jo në mënyrë të rregullt, kemi ngritur pretendime që kemi të bëjmë me moskëqyrjen nga kamerat e sigurisë të të gjitha qendrave të votimit kemi ngritur dyshime që rreth 50 veta në një qendër votimi kanë qenë jashtë shtetit dhe kanë votuar në atë kuti, por procesverbali i mbylljes së asaj kutie mua më rezulton që është i falsifikuar, dhe i shkruar dhe i nënshkruar nga një person, nga aktet e ekspertizës përkatës. Ne nuk kemi pasur mundësinë që të marrim pranë KQZ-së, personat të cilët kanë votuar sepse personat që kanë votuar, sipas asaj përgjigje verbale që kemi marrë nga Komisioneri, (qendra... ta shof pak, qendra) ne jemi drejtuar dhe sistemit TIM sepse një person që ne e kemi konstatuar, rezulton se ndodhet në shtetin grek dhe është larguar rreth 2 muaj më parë, dhe sipas asaj, është qendra 3417, ka rezultuar që një prej shtetasve që ka votuar, nga informacionet që kemi marrë ne, nga rrugë konfidenciale është larguar rreth 2 muaj jashtë shtetit. Kemi dhe kërkesën, të cilën ne do ta vëmë në dispozicion, që i jemi drejtuar sistemit TIMS, por duke iu referuar ligjit "Për të dhënat personale", ne nuk kemi akses që të marrim të dhëna për këtë shtetas, dhe jo pa qëllim në ankim, ju kemi kërkuar që të investohet ky kolegji, për marrjen e kësaj prove, sepse referuar faktit, siç e shpjegova

*Zbardhi materialin audio
Jona,DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

ligjit “Për të dhënat personale” nuk kemi e mundur që të marrim të dhëna për këtë shtetas. Ju vë në dispozicion dhe kërkesën që ne ke kemi ezauruar rrugën tonë, por nuk kemi marrë përgjigje zyrtare. Këto janë pak a shumë, ato të tjerat parregullsitë e mëteperme i lexoi dhe kolegu Altin Kazia. Kështu përfundimisht, ne kërkojmë pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Ne do t’ju kërkojmë! Sepse kemi një garë të pabarabartë që në fillim, domethënë kemi një garë të pabarabartë që nga momenti i nisjes së garës. Kemi një garë të zhvilluar në mënyrë jo të drejtë, të cilën ne e kemi provuar dhe kemi dhe një manipulim të të gjithë kutive të votimit, kjo e provuar që mungojnë në to aktet origjinale, që është detyrë që këto akte origjinale të qëndrojnë në kutitë e votimit, por janë zhdukur, kjo është e provuar me pamjet filmike. Për këto arsye, kërkojmë pavlefshmërinë e rezultatit të zgjedhjeve, pavlefshmërinë e të gjithë zgjedhjeve, sepse nuk është ndjekur një procedure e drejtë, për më tepër ne do marrim edhe pamjet filmike dhe në momentin që do këqyren si ato që ne ju kemi venë në dispozicion, ashtu edhe ato që ne do marrim nga qendrat e votimit, do konstatojmë që kemi të bëjmë me një pavlefshmëri absolute, kemi të bëjmë me një kaos, me një kasaphanë, me një makineri shtetërore, ku ligji thotë që nuk lejohet të marrë pjesë; kryetari i bashkisë ka nxjerre gjithë stafin në fushatë. Pra, në cilësinë e provës që do të depozitohet në këtë proces është vendimi me vulë apostile i dënimit të shtetasit Kreshnik Hajdari. Formulari i vetëdeklarimit, kemi pamje në një kuti e cila ndodhet që ka vula të grisura dhe të hedhura që realisht duhet të ishin në kuti, kemi pamje të cilat provojnë faktin se kutitë e votimit kanë qenë të pamonitoruara, që vërtetohet edhe me pamjet filmike që kanë qenë të pamonitoruara, por kemi edhe fotot të cilat provojnë që kemi një derë e cila nuk ka qenë e siguruar dhe kishte një hyrje tjetër jashtë asaj kryesore që... Kemi akte ekspertimi i datës 21.05.2023, i ekspertit të kriminalistikës Artan Rexhepi që provon që kemi të bëjmë me falsifikim të disa procesverbaleve për mbylljen e kutive, kemi kërkesën e datës, njëzetëgjashtë

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.08.06.2023

i pesti, që ne i jemi drejtuar sistemit TIMS, gjë që nuk kemi marrë përgjigje, dhe njëkohësisht dhe pamjet filmike që ne kemi depozituar, kemi dhe pamjet filmike të gjithë të KZAZ-së, ku ka ndodhur numërimi, ku provohet që tre tavolina nuk kanë qenë të monitoruara, aty mund të bëheh kasaphanë, mund të firmosej... Kush është qëllimi i monitorimit me kamera? Qëllimi i monitorimit me kamera është, që të mos ngjallen dyshime, dhe që ai vullnet që qytetarët kanë shprehur të jetë i provuar, gjë që kjo nuk është e provuar në asnjë moment. Për këto arsye ne do depozitojmë dhe provat t'ua vëmë në dispozicion.

Z. L. Maliqi: Një ndërhyrje të vogël, ndjesë. Përveç këtyre, nga informacionet që kam, dhe që pashë gjatë procesit të numërimit, që do të jetë edhe nga filmimet, pati tensione të shumta midis vëzhguesve tanë dhe numëruesve, dhe në disa raste raportimin online nuk i bënte sekretari i KZAZ-së po i bënte operatori që ishte caktuar nga KQZ-ja, ndërkohë që do të merrte miratimin e sekretarit. Një rast ishte që nga 17 fletë të pavlefshme raportohen 13 në KQZ, raste të tjera ishin, kur vëzhguesit tanë, të cilët, se ne s'kishim numërues në të gjitha tavolinat, vëzhguesit tanë nxirrnin kandidatin Lefter Maliqi 174 vota, ata raportonin në procesverbale në të gjitha 160 vota, ndërkohë që rrisnin kandidatin tjetër. Kështu që të gjitha këto dyshimet edhe në raportimet edhe procesverbalet edhe gjatë numërimit edhe të fletëve të pavlefshme e me radhë. Edhe në një rast tjetër që është për t'u habitur nga KZAZ-ja, që ka marrë edhe vendim aty, është që me dhjetëra fletë me vulë të rrëshqitura, në qytet, në Kuçovë dhe këta i kanë quajtur të vlefshme, pra vulat pothuajse kanë marrë gjysmën e fletës së votimit të kandidatit. Kështu që të gjitha këto dyshimet, dhe të tjera nëse do të hapim të gjitha kutitë do të shikohet dhe numri i serisë, se mund të jene futur fletë votimi, se ishte për t'u habitur te kutitë e fundit ndërkohë që unë isha 400 e ca vota para, të dy rreshtat e fundit, 4 kuti rresht 99 vota,

Zbardhi materialin audio

Jona DERVISHI




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

22 unë, 33, 100 njëra, 34, pra, tek këto 18-19 kutitë e fundit, ku te 7 kutitë e fundit, u bë debat i ashpër deri në konflikt dhe ne, falë ruajtjes së qetësisë u larguam. Kështu që, për të gjitha këto gjëra kemi dyshime të provuara dhe absolute që ky proces ka qënë i manipuluar qëllimisht për të nxjerrë fitues me çdo kusht kandidatin. Unë, le të jem live këtu, dua t'u them që Kryeministri një javë para kur erdhi në Kuçovë, s'e përmendi fare emrin edhe kur i kanë bërë pyetje 2 herë rresht, edhe në prezantimin e me radhë, nuk ka folur fare, me një fjalë për rezultatin e ngushtë, vetëm i është drejtuar kandidatit tjetër për këtë rezultat të ngushtë. Kështu që kam bindjen totale që Kryeministri s' duhet të përzihet në këtë proces pasi e di shumë mirë që ajo bashki u fitua dhe madje nën drejtimin e individit. Ashtu siç tha për Shkodrën, "u vlerësua njeriu –tha", kështu që edhe këtu e di shume mirë që Partia Socialiste ka humbur mbi 3 mijë vota, si parti, sepse unë kam marrë votat e socialisteve dhe demokrateve, ajo bashki ka humbur gjithnjë mbi 3 mijë vota, kështu që kam edhe një bindje totale edhe te vlerësimi real i juaj. Faleminderit.

Z. A. Llangozi: Edhe diçka, nëse i referohemi vendimit të marrë nga KZAZ, Kuçovë, për shtyrjen e orarit të numërimit, rezulton se, në vendim është thënë që: është hapur qendra e votimit në orën 12 e 40 minuta, ndërkohë, nëse ne i referohemi pamjeve filmike në 12 e 20 minuta, jo e 40, e 19 minuta fiks, janë futur njerëz, të cilët nuk kuptohet se çfarë janë, pra kur na qenka hapur qendra e votimit në orën 12 e 40, në orën 12 e 20, kemi njerëz që ndodhen, që janë te pjesa e kutive, kjo është e provuar, se e ka kapur këtë pjesë të hyrjes së personave. Kështu që për këtë arsye, gjithsesi, për të vërtetuar edhe faktin e parë, që ka të bëjë me garën e parë të barabartë në fushatë, ne e kemi kërkuar në bazë të ligjit përkatës dhe Kodit të Procedurës Civile, ne kërkojmë në thirrjen e cilësisë së dëshmitarit të shtetasit Kreshnik Hajdari, dhe të shtetasit Pëllumb Salillari. Kërkesën e keni me shkrim, është dy faqe. Sepse Pëllumb

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

Salillari ka qenë investitor, ka qenë person, i cili e ka kontrolluar, nga njëra anë merrte tendera, nga ana tjetër çonte çakull për rrugët e qytetit. Imagjinoje çakull për rrugët e qytetit, dhe fatkeqësisht dhe fatmirësisht mbas 5 ditësh, pasi përfunduan votimet, ky çakull e mori shiu, se ra një shi i vrullshëm, edhe iku. Për këtë arsye keni dhe kërkesën për...

Z. L. Maliqi: Dhe një ndërhyrje tjetër, përveç këtyre gjërave, si ajo përplasja që kemi pasur me këtë oligark, ditën e zgjedhjes, ditën e heshtjes elektorale, në orën njëmbëdhjete e gjysëm të natës, unë marrë informacion që ky shtetas, në një lokal, në periferi të Kuçovës, me disa të Partisë Socialiste, “po shpërndan vlera monetare”. Dhe kam vajtuar së bashku me tre të tjerë, kam debatuar, - e kanë dhënë të gjitha mediet, - dhe aty, e kam kapur me punonjës të bashkisë, me punonjës të Partisë Socialiste dhe një punonjës in e tij. Policia e Shtetit në këto momente merr dhe shoqëron bashkëshortin e kryetares së Partisë së Lirisë në kundërshtim me të gjitha rregullat dhe ligjet për verifikim në drejtorinë e Policisë së Beratit me forca operacionale, ndërkohë që, ngjarja ndodhi në Kuçovë, dhe verifikimi mund të ishte bërë në Kuçovë. Faleminderit!

Z. A. Llangosi: Këto janë prova të cilat ne i sjellim rishtas, përveç atyre që kemi depozituar me një listim provash, e keni me listim dhe përderisa kemi procesverbalin audio, i citova këto prova që janë më tepër, që ne i kemi mbledhur: këto janë aktet, këto janë provat.

Z. K. Bele: Ankimit tuaj me numër 74. Mirë faleminderit, avokat. Kërkesa juaj përfundimtare ishte për pavlefshmërinë e zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Jonq DERVISHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

Z. A. Llangozi: Kërkesa jonë përfundimtare është për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, por me plot bindjen ndoshta është e thatë aktualisht, nëqoftëse, ne do të verifikojmë të gjithë materialin që ne kemi depozituar janë me dhjetëra video të cilat provojnë, që kemi të bëjmë me një kasaphanë, qoftë para zgjedhjeve, qoftë ditën e zgjedhjeve. Kemi një drejtoreshë të bashkisë e cila shoqëron njerëz gjatë gjithë kohës, i merr i fut në qendrat e votimit, gjë që këto bien në kundërshtim me..... Unë, do t'i kërkoj këtij kolegji këqyrjen e çdo lloj prove dhe çdo lloj videoje, të cilën ne e kemi paraqitur, ashtu siç na i keni marrë, e provon vetë që Kreshnik Hajdari që ka shfytëzuar resurset, pasuritë tona, për t'i bërë reklamë vetes së vet në kohë fushate. Para ca kohësh unë kam shitur një makinë, e mori njeri dhe shtrihej në mes të qytetit, i dukesh makinë e bukur, por makina ishte e imja, por dhe ato lekë ishin tonat, dhe bënte reklamë kryetarit i bashkisë me fondet e shtetit shqiptar, në një moment ku kishte ndalim ligjor.

Z. K. Bele: Dakord, avokat, ju i përmbledhët, arritët dhe në konkluzione. Faleminderit! Duke qenë se përfaqësuesi i ankimit tjetër, konfirmoi pra avokat Kaziaj, konfirmoi atë çka ai ka parashtruar në kërkesën. Për palën tjetër, personat e interesuar?

Z. M. Legisi: Dakord i nderuar. Pretendimet tona do t'i jap në mënyrë të përmbledhur për të dyja kërkesat sepse dhe nga teksti duket që janë të njëjta nga përmbajtja e pretendimeve. Po fillimisht në lidhje me kërkesën ankimore të kandidati Lefter Maliqit, për sa i përket kërkesës për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, ne dëgjuam pretendime që kishin të bënin me shkelje, të cilat pala i pretendonte, por që kanë ndodhur gjithmonë jashtë qendrës së votimit, siç janë përdorimi i aseteve, apo le të themi, i burimeve njerëzore publike, por nuk u rezultuan ndonjëherë të denoncuar,


*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

nuk di të këtë ndonjë denoncim, për sa i përket veprimtarive të ndaluara, le të themi gjatë fushatës. Po ashtu në lidhje me kandidaturën e Partisë Socialiste zotit Kreshnik Hajdari, në datën 12.04.2023, me vendimin numër 318, konstatojmë që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka pranuar kërkesën e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, dhe ka urdhëruar verifikim të thellë të kësaj kandidature, duke deleguar tek Prokuroria e Përgjithshme, kryerjen e hetimit të thelluar. Tani Kolegji Administrativ, e ka pranuar ankimin kundrejt vendimit ndërmjet dhe ka urdhëruar që ky Kolegj të shqyrtojë edhe kërkesën e palës, në lidhje me këtë pjesë. Por në kushtet kur është në një juridiksion tjetër, siç është Prokuroria e Përgjithshme, po merret me këtë shqyrtim, ne vlerësojmë që kërkimi duhet rrëzuar, për shkak të mungesës, pasi verifikimi i kandidaturës sikurse pretendohet nga pala, nënkupton ndërhyrje në juridiksionin e në kompetencën e një organi tjetër, aktualisht për sa po hetohet. Po ashtu, ankuesi pretendon se ka persona që kanë denoncuar që janë shkatërruar vula, etj, etj. Ne vlerësojmë që procesi zgjedhor, nuk mund të varet, apo vlefshmëria apo pavlefshmëria e zgjedhjeve nuk mund të varet nga një denoncim sporadik që ndodh aty dhe nuk e dimë vërtetësinë e videos, autenticitetin e videos dhe materialeve të cilat mund të jenë reklamuar sepse nuk kemi asnjë provë aktualisht që ta shohim. Në lidhje me pretendimet e tjera që kanë të bëjnë me votimin e personave, të cilat sipas sistemit TIMS, kanë votuar në atë datë, ne vlerësojmë që edhe për marrjen e provave, ne vlerësojmë që është e padobishme për këtë proces sepse fakti që një person nuk figuron, figuron jashtë, apo pa hyrje në territorin shqiptar, por ka votuar, kjo nuk ia bën votën e pavlefshme, dhe kjo nuk e bën procesin të pavlefshëm. Tani një person, mund të ketë kaluar në mënyrë të rregullt në pikat kufitare që njeh ligji, që janë të ngritura sipas ligjit, sistemi mund të punojë, mund të mos punojë, në rastet kur nuk punon mund të mbahen shënime në mënyra të tjera, dhe nuk del i regjistruar në sistemin TIMS, por mund të këtë hyrë dhe në mënyrë të paligjshme në territorin

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

shqiptar, për sa kohë ai është një shtetas shqiptar, kjo nuk ia bën votën atij të pavlefshme nëqoftëse ai është identifikuar rregullisht në qendrën e votimit dhe ka votuar. Pra, sikurse në vlerësimin tim edhe të gjithë të këtë hyrë në mënyrë të kundraligjshme në territorin e Shqipërisë, por që janë shtetas shqiptar, kanë votuar si të tillë, në vlerësimin tim nuk e bën votën të pavlefshme dhe kërkesën për të marrë prova ta vlerësojmë, se e tejzgjat edhe me tej këtë proces. Po ashtu, ne nuk na u paraqit asnjë material zgjedhor, i cili të rezultojë indicie në lidhje me shkeljet e pretenduara. Në tërësi, i nderuar, ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës, dhe lënien në fuqi të vendimit të objekt ankimi e keni me shkrim, ja depozitojmë administratës. Faleminderit.

Z. A. Llangosi: Mundem të... Në lidhje me pretendimin e palës që, pretendon se në lidhje me formularin ...

Z. K. Bele: Dëgjo, të mbarojmë ne, se mund të këtë ndonjë pyetje, pastaj nga ju. Pra ju bëtë parashtrimin tuaj në këtë fazë para se të vijnë te ne... Ylli, për sa kohë bëhen gati, morëm një përgjigje për sa kohë i bëjmë gati ato filmimet?

Z. Y. Merhaj: Nesër në mëngjes janë gati nqs është dorëzuar...

Z. K. Bele: Pra nuk mbyllet sot?

Z. Y. Merhaj: Unë thashë 24 orë, por pyeta personin që i bën, do 4 – 5 orë tha ai.

Z. K. Bele: Mirë, nga ky moment, nëse do të ishte e mundur që dikush të punonte pasdite... Besoj që ka disponim nga pala për t'i marrë sot pasdite.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

Z. Y. Merkaj: Në darkë i bie...

Z. K. Bele: Dakord, llogarit që njerëzit janë edhe të lodhur, kanë muaj me zgjedhjet por nëse e kanë... Dakord! Kemi ndonjë pyetje në këtë fazë? Mirë avokat, ne mendojmë, që duke qenë se ju kërkuat marrjen e atyre provave, as unë s'kam pyetje në këtë fazë. Ju kërkuat, si me thënë e vutë si kërkesë të rëndësishme marrjen e filmimeve dhe do të çmonim që në seancën tjetër, ju të kishit ezauruar dhe këtë fazë, dhe aty ne zhvillojmë debatin e mëtejshëm lidhur me provat, që ta kemi. Nuk e di kolegët, besoj që... Atëherë duke qenë se sot, me shpresë, ndoshta dhe nesër në mëngjes ju, merrni ato filmimet, ku do lëmë në një seancë objektivist, do të lëmë...

Z. A. Llangozi: Në lidhje me pretendimet e palës mund t'i kundërshtoj, pak shkurtimisht? Edhe unë dy fjalë do them. Po ai më kundërshtoi, unë jo.

Z. K. Bele: Po mirë thuaj dy fjalë, po dy ama jo...

Z. A. Llangozi: Në lidhje me prapësimin që pala bëri, me formularin, që s'mund të gjykohet formulari i dekriminalizimit, kjo është një detyrë e lënë nga Kolegji tashmë, më saktë, dhe e drejta kjo është që duhet të gjykohet, dhe jo të presim institucione të tjera të hetojnë. Hetimi që ka nisur KQZ-ja, i përket hetimit kryesisht, të saj. Ndërkohë ky proces është me kërkesën time dhe është një proces, të cilin e provoj unë, dhe ne nuk kemi kërkuar të verifikohet çfarë do verifikohet, por ne kemi të verifikuar, dhe është proces që iniciojmë ne dhe në procesin që fillon me iniciativën tonë, barra e provës na bie ne si palë, gjë të cilën e kemi provuar tashmë para jush, por nga ana tjetër edhe mendimi organit procedues që në rastin konkret jeni ju, mundet të na ndihmoni në mbarëvajtjen e kërkesës, e keni detyrim, të na ndihmoni,

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

por kjo nuk do të thotë që detyrimisht duhet të provohet nga institucioni i KQZ-së. Ne e kemi provuar, është detyrë e lënë nga Kolegji që duhet të gjykohet, duhet hapur praktikë tashmë, jo të sorollatemi, duhet të vejë merita te i zoti, kështu që, kjo është.

Z. K. Bele: Kuptova. Dhe ne e kemi lexuar drejt vendimin e Kolegjit, që ne duhet të shprehemi, duhet të vlerësojmë edhe atë kërkimin e juaj, krahas të gjithave kërkimeve që keni bërë, pra në këtë pikë, nuk kemi ndonjë diskutim apo ndonjë debat. Atëherë dhe për shkak të faktit, që ju kërkoni marrjen e asaj prove që keni dhënë, do përgatiten edhe ato prova shkresore që ju kërkoni dhe ne, në seancën tjetër do debatojmë për ato prova. Ndërsa ju keni bërë një kërkesë të veçantë, krahas kërkesave për prova, për të cilat disponohen nga KQZ-ja, dhe ne tashmë e kemi vendosur që ato të administrohen në proces, ku të marrin kohën e vet, sa të nxirret formulari apo dhe diçka tjetër. Lidhur me kërkesën tuaj për dëshmitarë, ju risjell në vëmendje që pala tjetër para se ne të shprehemi, thjesht, nëse ju qëndroni apo jo, pala kërkuese që ju kërkoni, përfaqësohet nëpërmjet subjektit politik që përfaqëson, në praktikën e këtij Kolegji, në praktikën e kësaj Trupe, nuk janë thirrur dëshmitarë për qëllime, pra nuk kemi pasur praktikën e thirrjes se dëshmitarëve të kandidatëve apo të personave të tjerë privatë. Kjo për arsye dhe të natyrës së këtij procesi, i cili është një proces, ne funksionojmë si quasi (pothuajse) si gjykatë, gjykojmë a posteriori, kryesisht mbi dokumenta dhe mbi prova të administruara, qofshi këto shkresore dhe filmike.

Z. A. Llangozi: Po, por Kodi Zgjedhor e përcakton, dhe më saktë, kur e vlerëson dhe meqenëse është kërkesë dhe barra e provës na përket ne, në Kodin Zgjedhor është përcaktuar qartë që mundet të thirren dëshmitarë dhe rregulla e thirrjes se

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

dëshmitarit, zbatohet Kodi i Procedurës Civile dhe ne për këtë arsye është e zgjeruar kërkesa

Z. K. Bele: I qëndroni kërkesës tuaj!

Z. A. Llangozi: Ne i qëndrojmë kërkesës dhe kjo është në mbështetje të të gjitha atyre provave, të cilat ne i kemi bashkëlidhur. Kjo është një provë, ose më saktë një përforcim i provave që kemi sjellë se provat janë, por është një përforcim më tepër.

Z. K. Bele: Dakord!

Z. M. Legisi: Dakord, meqenëse kaluam te Kodi i Procedurës Civile, po nuk mund ta thërrasësh të paditurin ose paditësin, kur ai e ka përfaqësuesin aty, t'i thuash që të vijë pala aty, edhe si dëshmitarë t'i bëjë pyetjen nëqoftëse ka ndonjë pyetje, mund të na e bëj dhe t'i përgjigjemi.

Z. A. Llangozi: Por Kodi i Procedurës Civile e përcakton në mënyrë të qartë, që kur gjykata vendos thirrjen edhe palën e thërret, dhe kjo është e padiskutueshme.

Z. K. Bele: Mirë avokat, duke qenë se jemi para një kërkesë që, edhe për ne është hera e parë që bëhet, ne po tërhiqemi për dhomë këshillimi për ta vlerësuar me kujdes, dhe shprehemi për këtë kërkesë në mënyrë që ta ezaurojmë këtë fazë, kërkesën për prova e dëshmitarë në seancën tjetër të ecim me procesin. Dakord. Ne do ju njoftojmë shumë shkurt, se edhe koha... Kështu që do na jepni pak kohë... Nëqoftëse nuk do ngecim në debat të gjatë do mundohemi të përfundojmë shpejt.

*Zbardhi materialin audio
Jonq DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

Rifillon Mbledhja

Ora 16:04

Z. K. Bele: Riçelim seancën. Lidhur me kërkesën për marrjen e provës me dëshmitarë, duke pasur parasysh edhe atë që u parashtrua edhe nga avokati që këto prova janë në përforcim të provave shkresore, si dhe duke qenë në respekt dhe të leximit të nenit 231 devijues 33 dhe konkretisht të Kodit të Procedurës Civile, ne vlerësojme që të shprehemi lidhur me kërkesën, nëse do jetë apo jo e nevojshme thirrja, marrja e këtyre provave, mbas përfundimit të shqyrtimit të provave shkresore dhe materialeve filmike, duke vendosur dhe rendin kronologjik, logjik të debatit në këtë proces quasi gjyqësor. Ndërkaq, lidhur me këtë fazë ne çmojmë që të ndërpresim procesin dhe të lëmë seancën e radhës, t'ju japim kohë palëve që të pajisen me ato provat filmike të kërkuara, duke shpresuar që sot ose maksimumi nesër në mëngjes, për të lënë edhe një afat të arsyeshëm të kërkuar nga ju prej 3 ditësh. Atëherë ta lëmë seancën ditën e hënë, ndoshta në orarin e drekës, nga 12 e gjysma.

Z. A. Llangozi: Mirë ishte të kishim dhe kohë mjaftueshëm, se ne kemi dhe problemin... Dakord, dakord, se kam dhe afat...

Z. K. Bele: E lëmë të hënë në orën 1. Ndërkaq do ju kërkonim, duke qenë se ju keni bërë, keni sjellë një volum të madh dokumentash, siç thatë dhe vetë, janë nja dyqind video. Që ta bëjmë procesin sa më të arsyeshëm dhe më të përtypshëm dhe për ne, duke qenë se ky, është dhe një proces publik që ka dhe interes dhe nga palët e tjera të shihen, do ishte udhës që ju të identifikoni ato që janë thelbësore, sigurisht ne, secili nga ne do bëjmë dhe kopje, do mundohemi që ne të shikojmë. Në mënyrë që

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.06.2023*

ne mos të mos ta bëjmë si film serial, duhet të gjejmë ato gjëra që janë thelbësore për procesin që ju t'i evidentoni, dhe besoj, kjo është e realizueshme për seancën tjetër.

Z. L. Maliqi: Meqenëse me përfaqësuesin e Partisë Socialiste besoj që e kemi një mirëkuptim, por dhe një gjuhë, por dy kundërshtime të vogla, meqenëse i foli, i tha aty është që ne kemi bërë dy kallëzime në SPAK, për këto probleme që thamë para datës 14 të zgjedhjeve që janë bërë nga Partia Demokratike, dega Kuçovë.

Z. K. Bele: Jo për të heq fjalën, po duke qenë se ne do vijmë prapë të debati, dhe ju keni mundësi t'i thoni herës tjetër, dhe ne e kapërcyem këtë moment dhe herës tjetër ju...

Z. L. Maliqi: Dakord, po tërhiqem. Faleminderit!

Z. K. Bele: Mirë, me kaq seancën e mbylлим, për ta riçelur ditën e hënë në orën 13. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

